

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	30.01.2026	Përshëndetje të nderuar grupi Iso. Jam prof. xxxx drejtor i festivalit të këngës popullore në Rahovec – Kosovë. Jemi të interesuar që grupi i juaj të mar pjesë në festivalin i cili do të mbahet më 29 dhe 30 shtator 2026. Festivali jonë ju ofron akomodim moteli dhe darkë pas koncertit. Presim email tuaj. Me respekt Prof. *****	02.02.2026	I nderuar prof. ***** Ju falenderojmë për interesimin dhe përkushtimin tuaj si dhe për ftesën e adresuar për pjesëmarrje në “Festivalin e Këngës Popullore”, që do të zhvillohet më datat 29-30 shtator 2026 në Rahovec. Shprehim gatishmërinë tonë për të shqyrtuar mundësinë e pjesëmarrjes së grupit në këtë aktivitet me rëndësi kulturore dhe artistike. Për këtë qëllim, ju lutemi të na dërgoni në vijim informacion më të detajuar mbi kushtet e pjesëmarrjes, programin artistik, kriteret e përzgjedhjes si dhe çdo të dhënë tjetër që e konsideroni të nevojshme.	E plotë	Nuk ka

				Ju falenderojmë gjithashtu për sqarimin lidhur me akomodimin dhe darkën e ofruar nga organizatorët pas koncertit. Njëkohësisht, lutemi të krijoni mundësinë për të mbuluar edhe shpenzimet e transportit të grupit. Mbetemi në pritje të komunikimit tuaj të mëtejshëm. Ju falenderojmë edhe njëherë për vlerësimin dhe ftesën. Punë të mbarë!		
2.	02.03.2026	Përshëndetje, Jam ***** *****, anëtare e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. Ju drejtohem për të kërkuar informacion në lidhje me mbledhjen e fundit të zhvilluar, për të cilën nuk kam marrë njoftim me email. Në këtë kuadër, do të dëshiroja të dija arsyen e mosnjoftimit, si edhe të konfirmohet nëse	05.03.2026	Përshëndetje znj. *****, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion në lidhje me mbledhjen e fundit të zhvilluar të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, si dhe për kërkesën për lëshimin e një vërtetimi zyrtar, ju bëjmë me dije sa vijon: Bashkëlidhur këtij komunikimi gjeni Urdhrin e Ministrit nr. 147, datë	E plotë	Nuk ka

		vazhdoj të jem anëtare e Këshillit. Gjithashtu, kam nevojë për një vërtetim zyrtar nga Ministria, ku të specifikohet se jam anëtare e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Jomateriale që prej vitit 2020. Ju falënderoj paraprakisht për bashkëpunimin. Punë të mbarë!		25.02.2026, “Për lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”, të cilit i referohet urdhri i sipërcituar. Sa i takon kërkesës suaj për lëshimin e një vërtetimi zyrtar nga Ministria lidhur me statusin tuaj si anëtare e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale që prej vitit 2020, ju/ bëjmë me dije se Ministria është në dijeni të kësaj kërkesë dhe vërtetimi përkatës do t’ju përcillet brenda afateve ligjore të përcaktuara për trajtimin e kërkesave administrative.		
--	--	---	--	---	--	--

				Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju urojmë punë të mbarë.		
3.	03.03.2026	Shoqata Mbarëkombëtare “*****”, Tiranë–Prizren, e mbështetur në kërkesën referendare bashkëngjitur nga 110 subjekte-shoqata nga i gjithë vendi, trojet etnike shqiptare dhe mërgata shqiptare në Botë, që “Plisi i Bardhë”, të dërgohet për t’u regjistruar në UNESCO, si vlerë kombëtare Shqiptare e Botës. Kërkesë për dhënien e provave shkresore (fotokopje të njësuar me origjinalin, ose në formën e vërtetimit kur e dhëna e kërkuar nuk është në formën e një dokumenti) që gjenden pranë institucionit tuaj dhe kanë të bëjnë: Me mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, të dt. 27.02.2026, të cilat janë sa vijon:	17.03.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ardhur pranë Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale më datë 3.3.2026 që lidhet me mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të datës 27.02.2026 në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije se, në vijim të kërkesës suaj dhe në përputhje me secilën nga pikat e paraqitura prej jush, po ju përcjellim përgjigjen përkatëse si më poshtë: Pika 1. Rendi i ditës i mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, datë 27.02.2026 Bashkëlidhur gjeni rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore	E pjesshme	Nuk ka

	1)-Rendi i ditës i mbledhjes së Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, të dt. 27.02.2026. 2)- Procedurat e thirrjes së mbledhjes së Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, të dt. 27.02.2026. 3)-Vendimet e marra në mbledhjen e Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, të dt. 27.02.2026. 5)-Proces-verbalet e mbajtura gjatë mbledhjes së Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, të dt. 27.02.2026, ku të jenë pasqyruar diskutimet dhe vendimet përkatëse. 6)-Dosjen e plotë që është paraqitur në Këshillin Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, të dt. 27.02.2026, të propozimit që qelshja të miratohet element i trashëgimisë etno-kulturore, materiale, shpirtërore e	Jomateriale, të zhvilluar më datë 27.02.2026. Pika 2. Procedurat e thirrjes së mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, datë 27.02.2026 Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale thirret dhe zhvillohet në përputhje me rregullat e funksionimit të këtij organi dhe kompetencat përkatëse institucionale. Në kuadër të organizimit të mbledhjes së datës 27.02.2026, sekretaria teknike ka realizuar njoftimin dhe koordinimin me anëtarët e Këshillit, përmes komunikimeve elektronike (email) dhe komunikimeve telefonike, si dhe ka ndjekur procedurat administrative për përgatitjen dhe zhvillimin e mbledhjes. Pika 3. Vendimet e marra në mbledhjen e Këshillit		
--	--	---	--	--

	popullit shqiptarë, dhe më pas të dërgohet propozimi në UNESCO, etj. 7)-a) Kush janë anëtarët e Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, b) formimi i tyre akademik, c) C-V profesionale, d) vendimet përmes të cilat janë emëruar anëtarë të atij komiteti. 8) Rregullorja e organizimit dhe e funksionimit të Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale. 9)-Rregullat procedural të pranimi të propozimeve të ndryshme në Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, për në Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, pranë asajë Ministrie. 10)-Arsyja se perse në Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, nuk na është marrë në dorzim dosja e pregaditur që “Plisi i Bardhë” të regjistrohet si element i trashëgimisë tonë etno-		Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale Vendimet e marra në mbledhjen e datës 27.02.2026 janë hartuar dhe ndodhen në procesin e formalizimit, konkretisht në fazën e mbledhjes së firmave nga anëtarët përkatës, në përputhje me procedurat administrative në fuqi. Ato do të vihen në dispozicion pas përfundimit të nënshkrimit dhe hyrjes së tyre në fuqi, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat administrative në fuqi. Pika 5. Proces-verbalet e mbajtura gjatë mbledhjes Procesverbali i mbledhjes së datës 27.02.2026 është hartuar dhe ndodhet në procesin e formalizimit, konkretisht në fazën e mbledhjes së firmave nga anëtarët pjesëmarrës, në përputhje me procedurave administrative në fuqi.		
--	--	--	--	--	--


	kulturore, materiale e shpirtërore e popullit shqiptarë, (paraqitur elektronikisht qe me dt.11.02.2026)paraqitur fizikisht me dt.25.02.2026, kjo më arsyetimin se më dt.26.02.2026, është mbledhja e Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, dhe nuk do të kenë kohë për ta studjuar antaret e atij komiteti, ne një kohë kur ajo mbledhje u mbajt më dt.27.02.2026. 11)-Si dhe çdo aktë ligjor, nëneligjorë, urdhera, udhezime, vendime që kanë të bëjnë më organizimin dhe funksionimin e Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale. Baza ligjore: 1)-Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998, K.R.Shqipërisë, neni 21, 23, etj. 2)-Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, neni nr.10 i sajë. 3)-Ligji Nr.8116,datë 29.03.1996, (i ndryshimet)		Ai do të vihet në dispozicion pas përfundimit të nënshkrimit dhe miratimit të tij, në përputheje me legjislacionin dhe procedurat administrative në fuqi. Pika 6. Dosja e paraqitur për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, datë 27.02.2026 Në lidhje me kërkesën tuaj për vënien në dispozicion të dokumentacionit të dosjes së paraqitur në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të datës 27.02.2026, ju bëjmë me dije se dokumentacioni përkatës ndodhet në administrim pranë institucionit. Bashkëlidhur po ju përcjellim dokumentacionin e dosjes që nuk përmban të dhëna personale.		
--	--	--	---	--	--

	“K.Pr.C.neni 324, germa b) e etj. 4)-Ligji Nr. 49, datë 03. 05. 2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Gj. Ad. gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenet nr. 3,7,11,15,17, 18, 21, 26, 35. 5)-Ligji Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “K.P.A. Republikës së Shqipërisë” neni 6. 6)-Ligji Nr. 119, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” neni, 2, 3, 8, 11,13,14,18,25, dhe 26 të tij. 7)-Ligji Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, neni nr. 1, pika 7,8,10, neni 2, pika 7, 8, 9, 10, neni nr. 9, germa,pika 1, germa dh), neni 12, pika 1, neni nr. 13, pika nr. 2, neni nr. 20, pikat nr. 3 dhe 5. neni nr. 21, pika 2, neni nr. 23, pika 1, neni 24, neni , neni nr. 53, pika nr. 1, neni nr. 54, pika nr. 1,2,3, nenet nr. 54,55, 57, 59, 61, 63,64, dhe 65, pika 1, germa g), neni nr. 68, pika 1,dhe neni nr. 71, pikat nr. 1,2,3, e tijë. 8)-Ligji, nr. 55/2018, datë 23.07.2018, Për profesionin e		Kërkesat, Përshkrimin elementit, Materiale fotografike, Materiale arkivore, Foto të bibliografisë. Në përputhje me nenin 44 të Ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dokumentet që përmbajnë të dhëna personale të individëve, nuk mund të publikohen automatikisht pa pëlqimin e tyre, pasi e drejta për akses në informacion publik nuk mund të cenojë të drejtat themelore të individit, përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale. Pika 7. Përbërja e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të zhvilluar më datë 27.02.2026, morën pjesë këta anëtarë:		
--	--	--	--	--	--

	avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 11 i tij. E nderuara Zj.Drejtoreshë ! Se pari bëjmë më dijeni se kemi qenë dhe jemi në një proces të gjatë për aktualizimin e përdorimit komtarisht të “Plisit të Bardhë”, si “Simbol Kombëtar Shqiptar”, me të cilin lidhet identiteti ynë historik, por edhe etno-kulturore dhe regjistrimin e ti si vlerë të trashëgimisë tonë materiale, shpirtërore, etno-kulturore e me pas edhe në UNESCO, si vlerë të trashëgimisë Botërore, e popullit tonë.Pas një pregaditje te gjatë, dhe pasi e plotësuar dosjen perkatsë, vërejmë se kjo mundësi për momentin është penguar nga ana juaj si Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, qe dosja te kalontë për shqyrtim ne mbledhjen e dt.27.02.2026, ne mbledhjen e Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore jomateriale.		-Z. Blendi Gonxhja, Ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit - Kryetar -Znj. Benida Kraja, Drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Trashëgimisë Kulturore - Anëtar -Znj. Erilda Selaj, Drejtor i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale - Anëtar -Z. Sabian Hasani, Drejtor i Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore - Anëtar -Znj. Ana Bullari, Specialist, Sektori i Programimit, Hartimit, Harmonizimit të Akteve dhe Koordinimit të Mendimeve - Anëtar -Znj. Silvana Nini, Etnografe - Anëtar -Artan Ibërshimi, Koreograf - Anëtar		
--	--	--	---	--	--

		Për të vijuar në të drejtën tonë, se paku të pretenduar, kërkojmë informacionin e nevojshem ne formen e duhur ligjore. Prandaj për sa më sipër, sipas objektit të kërkesës në fjalë, kërkojmë një përgjigje pozitive apo negative qoftë ajo. Pra në qoftë se pranë jushë gjendën (e duhet të gjendën) të dhënat dhe aktet shkresore që kërkojmë, ato të na vihen në dispozicion sikurse është thënë edhe më lart, me vulë të njomë ose në mungesë të tyre, fotokopjet e akteve që gjendën të njësura me origjinalin përmes firmës së të ngarkuarit përkatës dhe vulës së institucionit. Duhet vënë në dukje fakti se, pushteti i sotshëm shtetërorë duke e vlerësuar këtë të drejtë dhe duke i njohur mirë ato fakte shkeljesh që rëndom ndodhin masivisht ne administratën shtetërore, e ka		Dokumentet që përmbajnë të dhëna personale të anëtarëve të Këshillit, si formimi akademik, CV-të dhe vendimet e emërimit, nuk mund të publikohen automatikisht pa pëlqimin e individëve. Kjo përputhet me nenin 44 të Ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale”, i cili parashikon se e drejta për qasje në informacion publik nuk mund të çenojë të drejtat themelore të individit, përfshirë të dhënat personale. Ligji nr. 124/2024 përcakton gjithashtu se përpunimi i të dhënave personale mund të bëhet ligjërisht vetëm nëse ekziston një bazë ligjore, si përmbushja e detyrimeve ligjore të institucionit ose për ushtrimin e funksioneve publike, por kjo nuk lejon publikimin e CV-ve të individëve pa pëlqimin e tyre. Ky informacion jepet në përputhje me		
--	--	--	--	---	--	--

	miratuar ligjin: Ligjin Nr.119/18.9.2014 “Për të drejtën e informimit”. Në kreun e II-të të emërtuar e drejta e informimit dhe transparenca, në nenin nr. 3, të emërtuar e drejta e informimit, të cilat i përkasin të ligjin Nr. 119/18.9.2014 “Për të drejtën e informimit”, është e sanksionuar se: 1)-Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. 2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar. 2. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. 4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t’i		legjislacionin në fuqi dhe me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale. Pika 8. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të institucionit është dokument publik dhe mund të aksesohet në faqen zyrtare të institucionit: https://folklor.gov.al/ Linku i drejtpërdrejtë për rregulloren: https://folklor.gov.al/rregullore/ Pika 9. Procedurat e pranimi të propozimeve pranë Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale Rregullat procedurale për paraqitjen dhe trajtimin e propozimeve për elemente të trashëgimisë kulturore		
--	--	--	--	--	--

		refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji. Në kreun e V-të të emërtuar, shkeljet dhe sanksionet administrative, neni nr.18, Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet, të Ligjin Nr.119/18.9.2014 “Për të drejtën e informimit”, është e sanksionuar se: 2.Veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë veprë penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë: a)-refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë; Kurse në Ligjin, nr.9109,datë 17.7.2003, Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë, (Ndryshuar me ligjin nr.9795,datë 23.7.2007,	jomateriale gjenden në platformën zyrtare: https://regjistratikj.al/procedura-e-aplikimit-per-inventarin-kombetar-te-trashegimise-kulturore-jomateriale/  Pika 10. Arsyja se perse në Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, nuk na është marrë në dorzim dosja e pregaditur që “Plisi i Bardhë” të regjistrohet si element i trashëgimisë tonë etno-kulturore, materiale e shpirtëqore e popullit shqiptarë, (paraqitur elektronikisht qe me dt.11.02.2026)paraqitur fizikisht me dt.25.02.2026, kjo më arsyetimin se më dt.26.02.2026, është mbledhja e Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, dhe	
--	--	---	--	--

		botuar në FZ nr.104), (Ndryshuar me ligjin nr. 10047, datë 24.12.2008, botuar në FZ nr.202,(Ndryshuar me ligjin nr. 91/2012, datë 27.9.2012,botuar në FZ nr.135,Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, neni 11 i tij. KREU II TË DREJTAT DHE DETYRAT E AVOKATIT, Neni 11 është e sanksionuar qe: Të drejtat e avokatit Avokati, në ushtrim të profesionit të tij, ka të drejtë: a) të ofrojë shërbimin e avokatisë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në mënyrë të lirë, të pavarur dhe autonome, pa kufizime, kundrejt çdo klienti, vendas ose të huaj, që ushtron veprimtarinë brenda ose jashtë vendit; Për çdo njërën nga obsionet e kërkimeve tona, sipas radhës së tyre duam një përgjigje		nuk do të kenë kohë për ta studjuar antart e ati komiteti, ne një kohë kur ajo mbledhje u mbajtë më dt.27.02.2026. Në lidhje me këtë çështje, ju sqarojmë se: Iniciativa për Rregjistrimin e Elementit të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të “Qeleshe, plis, kapuc, qylah, kopicë, qylaf, kësulë” ka qenë e QKVT. Duke vlerësuar punën e kryer nga shoqata që ju përfaqësoni, drejtori i institucionit ju ka kontaktuar në telefon më dt. 11.02.2026 duke shprehur mirënjohjen për punën që shoqata ka kryer ndër vite duke ju afruar të bëheshit pjesë e kësaj iniciative. Ju ka udhëzuar për të paraqitur zyrtarisht dosjen dhe ju ka ftuar në një takim pune për të detajuar të gjithë procesin. Institucioni ynë ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me ju lidhur me përgatitjen e		
--	--	--	--	--	--	--

		pozitive apo negative qoftë ajo. Kurse për të gjitha ato raste kur zotëroni dokumentacion përkatës, kërkojmë përgjigjen e kërkesave, se bashku më fotokopjet e njësuara me origjinalin, të atyre akteve, të cilat të bëhen përmes firmës së të ngarkuarit përkatës dhe vulës së institucionit. Për bazën dokumentare të kërkuar nga ne dhe që nuk disponohet nga ana juaj, por që keni dijeni, se ku mundet të gjenden ato, kërkojmë që të veproni në përmbushje të kërkesave të nenit 57,të ligji Nr.9154,datë 06.11.2003,”Për arkivat”, në të cilin është e sanksionuar se: “Nëse një arkiv nuk e ka dokumentin e kërkuar, kur është e mundshme, i tregon kërkuarit se ne cilin arkiv ose autoritet publik ndodhet, edhe nga ana juaj të na tregoni se ku ndodhet (ndodhën) ai (ato) dokument (dokumente) të kërkuara nga ana jonë.		dokumentacionit përkatës. Në vijim, nga ana juaj janë dërguar materiale në rrugë elektronike, të cilat ishin të paplota nga pikëpamja e dokumentacionit të kërkuar. Për këtë arsye, nga ana e institucionit gjatë komunikimeve telefonike dhe takimeve të zhvilluara pranë institucionit janë dhënë udhëzime konkrete lidhur me mungesat në dokumentacion dhe mënyrën e plotësimit të dosjes, në përputhje me kërkesat procedurale. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar disa komunikime dhe takime pune, gjatë të cilave nga ana e institucionit janë dhënë udhëzime konkrete për mënyrën e plotësimit të dokumentacionit, duke evidentuar edhe elementet që mungonin, si p.sh. kartela tip e elementit, kërkesën për rregjistrim etj., të cilat janë të domosdoshme për dosjen.		
--	--	---	--	--	--	--

		Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj, që të kemi një përgjigje shkresore, pozitive apo negative qoftë ajo, si dhe për aktet që janë vlerësuar sekret dhe nuk vihen në dispozicion për këtë arsye, të referohet akti përmes të cilit ato janë klasifikuar sekret, ose e kundërta e deklasifikimit të tyre. Kurse për çdo pikë të kërimit tonë, e ritheksojmë se kërkojmë që nga ana juaj të marrim një përgjigje pozitive apo negative qoftë ajo. Për këtë të fundit duke dhënë edhe arsyet e mungesave përkatëse. Po ashtu theksojmë, se për shërbimin e kryer nga ana juaj n.q.s. e përmban rregullorja e institucionit tuaj, garantojmë të bëjmë pagesën e duhur sipas rregullave të përcaktuara nga vetë ju për të tilla raste. Pres një përgjigje brenda afatit ligjorë, prej 10 ditësh, si dhe sipas kriterëve të tjera ligjore të përcaktuara edhe në ligjin		Sërisht ka qenë drejtori i institucionit që ju ka kontaktuar më dt. 25.02.2026 për t’ju dhënë mundësinë për të paraqitur dosjen. Megjithatë ku ju u paraqitët, gjatë verifikimit administrativ rezultoi se dosja nuk ishte ende e plotë sipas kërkesave të procedurës përkatëse. Me shumë dashamirësi, duke dashur t’ju përfshijmë në këtë proces ju është ofruar mundësia që materiali i paraqitur të bashkëlidhej me dosjen ekzistuese të elementit “Qeleshe, plis, kapuc, qylah, kopicë, qylaf, kësulë” për trajtim në mbledhjen e KKTKJ-së edhe pse dokumentacioni juaj nuk ishte i plotë. Kjo alternativë nuk është pranuar nga ana juaj duke kërkuar që dosja të ishte personale nën emërtimin “Plisi i Bardhë”. Në këtë kuadër, sqarojmë se nga ana e institucionit nuk ka pasur asnjë pengesë		
--	--	---	--	---	--	--

		Nr.119/18.9.2014 “Për të drejtën e informimit”. Duhet theksuar se gjatë Konferencës Kombëtare për të Drejtën e Informimit, mbajtur në Tiranë më 16.12.2025, kreu i qeverisë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë. Ai paralajmëroi saksione për ministrat dhe sekretarët e përgjithshëm që nuk zbatojnë afatet. Edi Rama:Ligji është i qartë: 10 ditë është koha për t’u përgjigjur. Kjo mund të jetë shumë. Nëse në ditën e 11 nuk ka përgjigje, përgjigja është sanksioni. Duhet të sanksionohet institucioni përgjegjës. Duhet të bëhet delegimi te sekretarët e përgjithshëm. Duhet të sanksionohen ministrat dhe sekretarët e përgjithshëm në ditën e 11. Në të kundërt jemi të detyruar që të ankojemi në rrugë administrative, gjyqësore apo edhe penale qoftë ajo. Për sa më sipër kërkoj që për çdo të dhënë të objektit të kërkesës në fjalë, të kemi një përgjigje shkresore, pozitive		për dorëzimin apo trajtimin e dosjes, përkundrazi është ofruar asistencë dhe orientim për plotësimin e dokumentacionit. Pika 11. Aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me organizimin dhe funksionimin e institucionit Aktet ligjore, nënligjore, udhëzimet dhe vendimet që lidhen me organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, në seksionin Programi i Transparencës: https://folklor.gov.al/programi-i-transparences/ Ju sigurojmë se institucioni ynë mbetet i angazhuar për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe për garantimin e transparencës në ushtrimin e funksioneve të tij.Ju falenderojmë për mirëkuptimin, Me respekt ***** *****		
--	--	--	--	---	--	--


		apo negative qoftë ajo, dhe kjo përgjigje të jetë brenda afateve e kriterëve ligjore. Mbetemi me shpresë, se kërkesa në fjalë do të merret në shqyrtim, dhe do të plotësohet sipas kriterëve dhe brenda afateve ligjore. Të na falni për shqetësimin dhe ju falënderojmë për mirëkuptimin. Presim një përgjigje brenda afateve dhe kriterëve ligjore. Me respekt nga ana jonë: Kërkues si avokat dhe individ ***** ** Kryetari i Shoqatës: ***** **				
	03.03.2026	Kërkesë për informacion mbi mbledhjen e KKTKJ, datë 27.02.2026	30.03.2026	Përcjellje dokumentacioni në vijim të përgjigjes ndaj kërkesës për informacion lidhur me mbledhjen e KKTKJ, datë 27.02.2026. Drejtuar: SHOQATËS MBARËKOMBËTARE “*****” dhe z. ***** **	E plotë	Nuk ka

				Në vijim të përgjigjes së mëparshme të institucionit tonë ndaj kërkesës suaj për informacion, lidhur me mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të datës 27.02.2026, dhe në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije se ju përcjellim dokumentacionin përkatës si më poshtë: Pika 3. Vendimet e marra në mbledhjen e KKTKJ, të datës 27.02.2026. Bashkëlidhur po ju përcjellim Vendimin nr. 1, datë 02.03.2026, të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. Pika 5. Proces-verbalet e mbajtura gjatë mbledhjes së KKTKJ, të datës 27.02.2026 ku të jenë pasqyruar diskutimet dhe vendimet përkatëse. Bashkëlidhur po ju përcjellim pjesën përkatëse të procesverbalit të		
--	--	--	--	--	--	--

				mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, të zhvilluar më datë 27.02.2026, që lidhet me trajtimin e elementit: “Dijebërja e qeleshes (kapticë, kapuç, kësulë, plis, qylaf, qylah, takije)”. Procesverbali përcillet në formë të pjesshme, duke përfshirë vetëm pjesën që lidhet me objektin e kërkesës suaj. Dokumentacioni i mësipërm vihet në dispozicion në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, Me respekt,		
4.	04.03.2026	Quhem ***** dhe kam përfunduar Masterin Shkencor në Arkeologji. Së fundmi kam parë njoftimin për pozicionin e arkivistit dhe jam shumë i	05.03.2026	Përsëndetje, Ju falënderojmë për interesimin tuaj për pozicionin e punës “Punonjës Arkivi” pranë	E plotë	Nuk ka

		interesuar të aplikoj për këtë vend pune. Do të vlerësoja shumë nëse mund të më informonit mbi procedurën e aplikimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet përkatëse. Ju falënderoj paraprakisht për kohën dhe vëmendjen tuaj. Mbetem në pritje të përgjigjes suaj. Me respekt, ***** **		Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale. Ju lutemi t'i referoheni linkut të mëposhtëm, ku gjeni njoftimin e plotë, kriteret dhe detajet e procedurës së aplikimit: https://folklor.gov.al/elementor-3122/ Pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve, kandidatët do të njoftohen për rezultatin. Ju urojmë suksese!		
5.	04.03.2026	Përshëndetje! Kam parë njoftimin tuaj për vend pune si punonjëse arkive dhe dëshiroja t'ju pyes nëse mund të aplikojmë edhe ne që nuk kemi përvojë pune në këtë fushë, por kemi përfunduar studimet përkatëse. Gjithashtu, ju lutem të më informoni nëse kërkohet letër rekomandimi nga ndonjë pedagog si pjesë e dokumentacionit të aplikimit.	05.03.2026	Përshëndetje, Ju falënderojmë për interesimin tuaj për pozicionin e punës "Punonjës Arkivi" pranë Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale. Ju lutemi t'i referoheni linkut të mëposhtëm, ku gjeni njoftimin e plotë, kriteret dhe detajet e procedurës së aplikimit:	E plotë	Nuk ka

		Faleminderit për kohën dhe vëmendjen tuaj.		https://folklor.gov.al/elementor-3122/ Pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve, kandidatët do të njoftohen për rezultatin. Ju urojmë suksese!		
6.	05.03.2026	Faleminderit për njoftimin! Besoj se, në vijim, do të procedohet edhe me shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. Punë të mbarë!	05.03.2026	Përsëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj lidhur me shpërblimin si anëtare e KKTKJ, ju bëjmë me dije se, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 10.04.2019, “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”, referuar kreut V - Shpërblimi i anëtarëve të këshillit: <i>"Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje , për çdo anëtar, bëhet sipas VKM për përcaktimin e masës së shpërblimit të këshillave, bordeve ose</i>	E plotë	Nuk ka

				<i>komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore".</i> Përsa kohë nuk keni marrë pjesë në mbledhje nuk trajtoheni me shpërblim dhe fondet e institucioneve buxhetore qendrore nuk mbarten nga një vit tek tjetri. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, ju urojmë punë të mbarë.		
7.	06.03.2026	Pershendetje faqja nuk hapet linku 	06.03.2026	Përsëritet, Ju falënderojmë për njoftimin. Mund të ketë qenë një ngarkesë e përkohshme e sistemit. Faqja është në funksion: www.folklor.gov.al Po ju nisim më poshtë linket direkt të njoftimit: https://folklor.gov.al/wp-content/uploads/2026/03/Shpallje-per-vend-te-lire-pune-Punonjes-arkivi-1.pdf https://folklor.gov.al/elementor-3122/ Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

8.	30.03.2026	Përshëndetje, Uroj të jeni mirë! Po ju rikujtoj në lidhje me lëshimin e vërtetimit tim për anëtarësimin në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Jomateriale për periudhën 2020–2026. Faleminderit!	01.04.2026	Përshëndetje znj. *****, Në vijim të komunikimeve të mëparshme dhe në referim të kërkesës suaj për lëshimin e vërtetimit zyrtar mbi anëtarësimin në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, ju informojmë se kërkesa juaj është përcjellë sërish me prioritet pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit për trajtim. Vërtetimi do t'ju përcillet nga Ministria sapo të përfundojnë procedurat përkatëse. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, Ju urojmë punë të mbarë!	E plotë	Nuk ka
9.	23.04.2026	Përshëndetje! Me interes kemi ndjekur veprimtaritë tuaja dhe ju përgëzojmë. Një grup gra e vajza artizane në Kukës bashkëpunojnë mes tyre për të	23.04.2026	Përshëndetje, Ju falenderojmë për interesimin tuaj! Vlerësojmë punën tuaj në fushën e artizanatit dhe dëshirën për të qenë pjesë e aktiviteteve tona.	E plotë	Nuk ka

		realizuar produkte artizanale tradicionale. Ato kanë marrë pjesë në shumë panairë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ato janë shumë të interesuara që të jenë pjesë e aktiviteteve dhe mbështjetjes tuaj! Lutemi, na informoni nëse është e mundur kjo gjë! Me respekt, **** *		Ju informojmë se këtë vit QKVT do të organizojë Panairin Kombëtar të Artizanatit. Në momentin që do të përcaktohen detajet organizative, do t'ju njoftojmë lidhur me mundësinë e pjesëmarrjes. Ju urojmë punë të mbarë!		
10.	24.04.2026	Përshendetje, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Lipjanit, përmes kësaj shkrese dëshirojmë të informohemi se si mundemi të marrim pjesë në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës. Duke pasqyruar se në Komunën tonë kemi shumë grupe, shoqëri të cilat merren me Folklor, dëshirojmë që të u'ajpim mundësinë që të marrin pjesë në Festivale të ndryshme që ti paraqesin vlerat e veta. Duke mos pasur adresë tjetër, ne ju drejtohem juve që të na ndihmoni në këtë drejtim dhe të na jepni mundësinë që të	27.04.2026	Përshendetje z. *****, Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 24.04.2026, ju bëjmë me dije se, aktualisht institucioni ynë nuk disponon informacion lidhur me zhvillimin e Festivalit Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës. Ndërkohë, ju informojmë se grupi juaj është i mirëpritur të marrë pjesë si grup përshendetës në natën e dytë në: Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të	E plotë	Nuk ka

		jemi konkurues me një grup nga Komuna jonë pjesmarrëse në Festivalet e juaja.		Lojërave Popullore dhe Riteve që do të zhvillohet në datën 1 dhe 2 Maj 2026 në qytetin e Burrelit. Institucioni ynë mbulon shpenzimet për 1 (një) natë akomodim dhe ushqim (data 2 maj 2026). Gjithashtu, në kuadër të kalendarit vjetor 2026, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale do të organizojë edhe festivalet e mëposhtme: "Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Sazeve Popullore"; "Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë"; Detajet organizative dhe procedurat e pjesëmarrjes për këto aktivitete do t'ju komunikohen në vijim, me afrimin e datave përkatëse.		
--	--	--	--	--	--	--

				Duke ju falënderuar dhe duke shpresuar në një bashkëpunim të frytshëm të përbashkët,		
11.	29.04.2026	Përshëndetje, Quhem **** * dhe jam duke realizuar një dokumentar të shkurtër artistik, i cili do të prezantohet në festivale ndërkombëtare filmi. Po ju kontaktoj sepse jam e interesuar të përdor këngën tradicionale “Kënga e Nënës”, në veçanti versionin e interpretuar nga Grupi i Tepelenës. Do të doja shumë ndihmën tuaj për të më vënë në kontakt me grupin ose përfaqësuesit e tyre ose të më orientoni se kujt duhet t’i drejtohem për të marrë të drejtat e përdorimit të kësaj kënge për projektin tim Projekti është me karakter kulturor dhe jo-komercial (për festivale).	29.04.2026	Përshëndetje znj. **** *, Ju falenderojmë për interesimin dhe për vlerësimin ndaj trashëgimisë sonë kulturore. Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se për t’u orientuar lidhur me grupin e Tepelenës, mund të kontaktoni z. **** në numrin: ****. Për sa i përket të drejtave të përdorimit të këngës, ju sugjerojmë që të komunikoni drejtpërdrejt me përfaqësuesin/grupin përkatës, me qëllim marrjen e miratimit të nevojshëm për	E plotë	Nuk ka

		Ju falënderoj shumë për kohën dhe mbështetjen tuaj. Me respekt, **** *		përdorimin e saj në projektin tuaj. Ju urojmë suksese në realizimin e dokumentarit!		
12.	04.05.2026	Përshëndetje, Dua t'ju bëj me dije se kam hasur probleme në dërgimin e materialeve për konkursin e logos, duke marrë si mesazh automatik nga "Postmaster", emailin si ne foton bashkëngjitur. Ne pritje te nje komunikimi te dyte dhe zgjidhjeje nga ana juaj per marrjen e materialeve te siperpermendura. Me respekt, *****	05.05.2026	Përshëndetje z. *****, Ju falenderojmë për njoftimin dhe për interesimin tuaj për të marrë pjesë në konkursin e logos. Nga mesazhi automatik i përcjellë prej jush, rezulton se emaili është bllokuar nga sistemi për shkak të politikave të sigurisë lidhur me bashkëngjitjet/file-t e dërguara. Për zgjidhjen e situatës, lutemi të na i ridërgoni materialet në një nga mënyrat e mëposhtme: Ti dërgoni file-t në format PDF/JPG/PNG, të kompresuara në madhësi më të vogël;	E plotë	Nuk ka

				Ti ngarkoni materialet në Google Drive/WeTransfer dhe të na dërgoni linkun e aksesit; Ti dërgoni materialet në disa email-e të ndara, nëse janë me madhësi të madhe. Për çdo informacion shtesë mbetemi në dispozicion. Ju falenderoj!		
13.	08.05.2026	Përshëndetje, Shpresoj të jeni mirë. Po ju shkruaj për t'u interesuar mbi statusin e procesit të vlerësimit për identitetin e ri vizual të QKVT, pas aplikimit tim në këtë konkurs. Duke analizuar kërkesat e konkursit, kam besim të plotë se propozimi im përputhet më së miri me kriteret tuaja të vlerësimit. Qasja ime është fokusuar në kreativitet dhe origjinalitet, duke u siguruar që logoja jo vetëm reflekton thellësisht misionin dhe identitetin e institucionit tuaj, por gjithashtu ofron një cilësi	11.05.2026	Përshëndetje z. ****, Ju falenderojmë për interesimin dhe për pjesëmarrjen tuaj në konkursin për realizimin e logos dhe identitetit të ri vizual të Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale. Ju bëjmë me dije se procedura e shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve është ende në proces dhe ende nuk ka përfunduar.	E plotë	Nuk ka

		të lartë vizuale, koherencë dhe funksionalitet të provuar në aplikime të ndryshme. Gjithashtu, dëshiroj t'ju shpreh gatishmërinë time të plotë për të bashkëpunuar ngushtë me ju në hapat e mëtejshëm. Nëse ka detaje të propozimit që dëshironi t'i rishikojë apo përshtatni, jam shumë i hapur për të reflektuar sugjerimet tuaja. Qëllimi im është ta përmirësojmë më tej dizajnin së bashku, për të arritur rezultatin final ideal për QKVT. Ju falënderoj për kohën dhe punën tuaj gjatë këtij procesi. Mbetem në pritje të një përgjigjeje nga ana juaj.		Pas përmbylljes së procedurës, do të njoftoheni zyrtarisht. Ju falenderojmë për mirëkuptimin!		
14.	09.05.2026	Të lutem më nis eventet çfarë datë bëhen festivalet ?		Përsëndetje z. *****, Në përgjigje të interesimit tuaj, ju bëjmë me dije se gjatë muajit qershor parashikohet të zhvillohet në Ersekë dhe Leskovik: "Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Sazeve Popullore".	E plotë	Nuk ka

				Aktualisht jemi ende në fazë diskutimi dhe koordinimi organizativ, ndaj datat zyrtare të festivalit nuk janë përcaktuar ende. Sapo të jenë vendosur datat përfundimtare, do t'ju bëjmë me dije. Gjithashtu, informacioni zyrtar do të publikohet edhe në kanalet tona zyrtare në Facebook - (Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale) dhe Instagram (qkvt.albania), ku ju ftojmë të na ndiqni. Ju falenderojmë për interesimin tuaj!		
15.	18.05.2026	Përshëndetje, Kam vënë re se në të gjitha materialet promovuese të festivalit tipologjik kombëtar është përdorur një elemente grafik i krijuar nga ana ime në propozimin e dorëzuar në kuadër të konkursit për logon.	21.05.2026	Përshëndetje, Në përgjigje të emailit tuaj, nëpërmjet të cilit kërkoni sqarim lidhur me përdorimin e një elementi grafik në materialet promovuese të Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Lojrave	E plotë	Nuk ka

		Duke qenë se nuk kam marrë asnjë njoftim zyrtar dhe nuk është lidhur asnjë marrëveshje mbi përdorimin e materialeve të mia, kërkoj një sqarim zyrtar mbi: A është konsideruar projekti im fitues? bazën mbi të cilën po përdoren punimet e mia; dhe pozicionin tim në këtë konkurs. Statusin e autorësisë dhe pronësisë së materialit të dorëzuar nga ana ime Më poshtë keni PDF e materialit të përdorur nga ana juaj. Pres një përgjigje nga ana juaj sa më parë te jetë e mundur. Faleminderit		Popullore dhe Riteve, ju bëjmë me dije se: Elementi grafik i përdorur në materialet promovuese të festivalit nuk është marrë nga propozimi i dorëzuar nga ana juaj në kuadër të konkursit për logon dhe identitetin e ri vizual të QKVT-së. Ky element është përdorur si motiv grafik dekorativ me referencë nga burime të hapura vizuale, përfshirë platforma publike si Pinterest, ku motive të ngjashme janë të aksesueshme gjerësisht. Po ashtu, i njëjti tip elementi grafik është përdorur edhe më herët në materiale promovuese të tjera, përfshirë materialet e përdorura në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit në Berlin, ITB Berlin dt. 3-5 mars 2026. Bashkëlidhur gjeni foto ilustruese dhe video përmes të cilave evidentohet se elementi grafik në fjalë është përdorur edhe në		
--	--	---	--	--	--	--

				materiale të mëparshme promovuese, ndër të tjera në kuadër të Panairit Ndërkombëtar të Turizmit në Berlin, ITB Berlin. Gjithashtu, në linket më poshtë paraqiten edhe referenca vizuale të aksesueshme në platforma publike, si Pinterest, ku shfaqen motive të ngjashme grafike me karakter dekorativ dhe tradicional. Sa i përket konkursit për logon dhe identitetin e ri vizual të QKVT-së, ju informojmë se procedura nuk është ende e mbyllur. Pas përfundimit të procesit administrativ dhe vlerësues, pjesëmarrësit do të njoftohen zyrtarisht mbi rezultatin dhe vendimmarrjen përkatëse. Ju falenderojmë për mirëkuptimin.		
16.	02.06.2026	Te nderuar! Ne cilesine e pergjegjeses se Pallatit te Kultures "Riza Cerova" , Bashkia Skrapar, ju falenderojme për ftesen e derguar per pjesemarrjen ne Festivalin	03.06.2026	Të nderuar, Në përgjigje të kërkesës suaj për sqarim lidhur me pjesëmarrjen e grupit përfaqësues të Iso-Polifonisë së Skraparit në Festivalin Folklorik	E plotë	Nuk ka

		Folklorik Tipologjik Kombëtare të Sazeve Popullore. Deshirojme të marim një sqarim lidhur me kriteret e pjesëmarrjes. Grupi ynë përfaqësues është grup i isopolifonise së Skraparit dhe jo formacion sazes. Për këtë arsye, ju lutemi të na konfirmoni nëse grupi ynë mund të marrë pjesë në festival dhe nëse repertori i isopolifonise përputhet me kriteret artistike të përcaktuara për këtë veprimtari. Duke ju falenderuar paraprakisht për përgjigjen dhe bashkëpunimin, mbetemi në pritje të sqarimit tuaj. Me respekt, ***** ***** ,Përgjegjëse pallati i Kulturës "Riza Cerova" Bashkia Skrapar.		Tipologjik Kombëtar të Sazeve Popullore, ju bëjmë me dije se kjo veprimtari ka karakter tipologjik dhe i dedikohet posaçërisht formacioneve të sazeve popullore. Për rrjedhojë, kriteret artistike dhe organizative të festivalit lidhen me pjesëmarrjen e grupeve, instrumentistëve dhe formacioneve që përfaqësojnë traditën e sazeve popullore, si dhe repertorin përkatës instrumental dhe vokalinstrumental të kësaj tipologjie. Duke qenë se grupi i propozuar nga ana juaj përfaqëson isopolifoninë e Skraparit dhe jo formacionin e sazeve popullore, pjesëmarrja e tij nuk përputhet me profilin tipologjik të kësaj veprimtarie. Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale vlerëson traditën e isopolifonisë së Skraparit dhe mbetet e hapur për bashkëpunime në		
--	--	--	--	---	--	--

				veprimtari të tjera që lidhen me këtë tipologji. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, Ju uroj punë të mbarë!		
17.	20.07.2026	Përshëndetje, Jam i interesuar të shoh pamje filmike nga Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës i vitit 1973. Kërkoj veçanërisht pamje të grupit folklorik të Skraparit, ku mund të ketë marrë pjesë këngëtari Nazmi Bregu nga fshati Nishicë, Skrapar. Ju lutem më njoftoni nëse këto materiale ruhen në arkivin tuaj dhe si mund të konsultohen, jan te gjyshit dhe nuk kemi asnje material te tij Faleminderit.	20.07.2026	Përshëndetje, I nderuar z. *****, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, duke qenë se nuk dispononte informacionin e kërkuar, e përcolli kërkesën tuaj për kompetencë pranë Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit. AQSHF na ka informuar se ju i jeni drejtuar edhe drejtpërdrejt këtij institucioni me të njëjtën kërkesë dhe se ju është vënë në dispozicion për vizionim dokumentari i prodhuar nga Kinostudio mbi Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës të vitit 1973. Ju falenderojmë për interesimin tuaj! Ju urojmë gjithë të mirat!	E plotë	Nuk ka